

LIGJ PËR BYRONË E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

TEKST I KONSOLIDUAR Ligj për byronë e zhvillimit të arsimit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 37/2006; 142/2008; 148/2009; 69/2013; 120/2013; 148/2013 dhe 41/2014).

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen kompetencat e Byrosë për zhvillimin e arsimit (në tekstin e mëtejshëm: Byroja), si dhe çështje të tjera me rëndësi për zhvillimin dhe përparimin e edukimit dhe arsimit.

Neni 2

Byroja është organ i administratës shtetërore në përbërje të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me cilësinë e personit juridik dhe kryen punë profesionale me rëndësi për zhvillimin dhe përparimin e edukimit dhe arsimit në Republikën e Maqedonisë.

Neni 3

Kompetencat e veta të përcaktuara me këtë ligj dhe ligj tjetër, Byroja i kryen në bazë të parimeve të ligjshmërisë, profesionalizimit, përgjegjësisë, efikasitetit dhe transparencës.

Kryerjen e punëve nga kompetenca e vet, Byroja e bazon në metodat shkencore dhe profesionale në edukim dhe arsim dhe në qasjen strategjike në zbatimin e tyre.

Neni 4

Organizimi i brendshëm i Byrosë përcaktohet në pajtim me kompetencat e saj, në bazë të ligjit, dispozitave dhe akteve të tjera që kanë të bëjnë me format organizative dhe në pajtim me zhvillimin e rrjetit të shkollave dhe gjuhën në të cilën realizohet mësimi.

Selia e Byrosë është në Shkup.

II. KOMPETENCAT E BYROSË

Neni 5

Byroja është kompetente për përcjelljen, shqyrtim profesional, hulumtimin, përparimin dhe zhvillimin e veprimtarisë edukativo-arsimore në lëmin e arsimit parashkollor, fillor, të gjimnazit, në lëmin e arsimit mbi artet, në lëndet e arsimit të përgjithshëm në shkollimin e mesëm profesional, në arsimin e specializuar dhe në arsimin e të rriturve, arsimin e fëmijëve me nevoja të posaçme arsimore, veprimtarinë edukativo-arsimore në konvikte, si dhe për arsimimin e fëmijëve të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë jashtë vendit për mësimin e gjuhës amtare dhe kulturës.

Neni 6

Në kryerjen e kompetencave të përcaktuara me këtë ligj, Byroja:

- 1) i propozon ministrit të Arsimit dhe Shkencës koncepte për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe i propozon plan mësimorë për arsimin parashkollor, fillor, të mesëm dhe të specializuar, arsimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe për arsimin e të rriturve;
- 2) i propozon ministrit të Arsimit dhe Shkencës programe mësimore për arsim parashkollor, fillor, gjimnaz dhe arsim të mesëm të artit, lëndët e përgjithshme mësimore në arsimin e mesëm profesional, në arsimin e specializuar, si dhe për arsimin e të rriturve, arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, veprimtarinë edukativo-arsimore në konviktet e nxënësve, si dhe arsimin e fëmijëve të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë jashtë vendit për mësimin e gjuhës amtare dhe të kulturës;
- 3) organizon dhe realizon aktivitete për zhvillimin profesional të kuadrove edukative arsimore dhe udhëheqëse;
- 4) kryen dhe organizon hulumtime në sferën e arsimit;
- 5) kryen punë këshillëdhënëse profesionale për përmirësimin e kualitetit në institucionet edukative arsimore;
- 6) kryen shqyrtim profesional në mënyrën e planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore dhe të vlerësimit dhe të sigurimit të mjedisit stimulues gjatë realizimit të njësive mësimore nga ana e mësimdhënësve, si dhe përmes shqyrtimit të drejtpërdrejtë të rekomandimeve të dhëna nga vizitat e realizimit të njësive mësimore nga ana e bashkëpunëtorëve profesionalë;
- 7) përpilon standarde arsimore, standarde të arritjeve të nxënësve dhe realizon aktivitete për vlerësimin e arritjeve të nxënësve;
- 8) përpilon koncept për libër mësimor, program për botimin e librave mësimorë dhe metodologji për vlerësimin profesional të dorëshkrimeve të librit mësimor dhe për vlerësimin e kualitetit të librit mësimor;
- 9) kryen veprimtari botuese të lidhur me zhvillimin e veprimtarisë edukative arsimore,
- 10) i propozon Qendrës Shtetërore të Provimeve, teste për kontroll ekstern të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor, të gjimnazit dhe të artit, si dhe për lëndët e përgjithshme mësimore në arsimin e mesëm profesional, të cilat i dorëzon më së voni tre muaj para ditës së testimit dhe
- 11) i propozon Qendrës Shtetërore të Provimeve, orar të përgjithshëm për kontroll të arritjeve të nxënësve për lëndët në arsimin fillor, të gjimnazit dhe të artit, si dhe për lëndët e përgjithshme mësimore në arsimin e mesëm profesional, të cilin e dorëzon më së voni deri më 1 nëntor për vitin shkollor rrjedhës.
- 12) vendos dhe zhvillon sistemin informativ dokumentues në sferën e arsimit që është në kompetencë të saj.

Neni 7

Në kryerjen e kompetencave nga neni 6 pika 1 dhe pika 2 e këtij ligji, Byroja i kryen punët si vijon:

- përgatit analiza dhe në bazë të të njëjtave i përcakton nevojat për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor, si dhe nevojat për zhvillimin e plan-programeve mësimore;
- organizon diskutime profesionale për nevojat e përpilimit të plan-programeve mësimore;
- përgatit dhe i propozon ministrit të Arsimit dhe Shkencës plan-programe mësimore;
- i propozon ministrit të Arsimit dhe Shkencës, programe mësimore të adaptuara dhe të përkthyer në gjuhët në të cilat realizohet mësimi në Republikën e Maqedonisë nga Qendra Ndërkombëtare për Programe Mësimore e Kembrixhit (Cambridge International

Examinations) për arsimin fillor, në pajtim me ligjin;

- ngrit iniciativë për përpilimin e programeve mësimore;
- planifikon në bazë afatgjate rishqyrtimin e planprogrameve ekzistuese mësimore;
- kryen rishqyrtimin periodik të harmonizimit të programeve mësimore dhe qëllimeve të arsimit, në pajtim me dokumentet strategjike dhe ligjet;
- përgatit plane vjetore për nevojat e ndryshimit dhe plotësimit të programeve ekzistuese mësimore, përkatësisht për përpilimin e programeve të reja mësimore;
- shpall konkurs publik për sigurimin e shërbimeve në përpilimin e programeve të reja mësimore, përkatësisht për modernizimin e programeve mësimore ekzistuese, përveç për programet mësimore nga alineja 4 e këtij neni, në pajtim me ligjin,
- e përcjell punën e ekipeve profesionale për përpunimin e programeve mësimore, në lidhje me kualitetin dhe kryerjen e shërbimeve në pajtim me afatet e përcaktuara.
- paraqet informata për plan-programet e përpiluara mësimore në Inspektoratin shtetëror të arsimit dhe në institucionet edukative arsimore;
- bën promovim, jep udhëzime didaktike (trajnime) dhe e ndjek zbatimin (monitorimin) e programeve mësimore të adaptuara dhe të përkthyer nga alineja 4 e këtij neni në bashkëpunim me Qendrën Ndërkombëtare për Programe Mësimore të Kembrixhit (Cambridge International Examinations), e në pajtim me marrëveshjen në të cilën përcaktohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella,
- bën promovimin dhe jep drejtime didaktike për zbatimin e plan-programeve mësimore;

dhe

- e përcjell zbatimin e plan-programeve mësimore në kuadër të kompetencave të saj.

Neni 8

Në realizimin e kompetencave nga neni 6 pika 3 e këtij ligji, Byroja i kryen punët si vijon:

- përpilon analiza dhe në bazë të të njëjtave i përcakton nevojat për zhvillimin profesional të kuadrit edukativo-arsimor dhe udhëheqës;
- organizon diskutime tematike lidhur me zhvillimin profesional të kuadrit edukativo-arsimor dhe udhëheqës;
- përpilon plan afatgjatë për nevojat e trajnimit të kuadrit edukativo-arsimor dhe udhëheqës;
- përpilon plan afatgjatë dhe planin vjetor të aktiviteteve për trajnimin e kuadrit edukativo-arsimor dhe udhëheqës;
- bën bashkimin e planeve dhe kërkesës së aktiviteteve për trajnimin e kuadrit edukativo-arsimor dhe udhëheqës;
- i zbaton procedurat e akreditimit për sigurimin e shërbimeve lidhur me zbatimin e programeve për trajnimin e kuadrit edukativo-arsimor dhe udhëheqës;
- lidh marrëveshje me institucionet e akredituara, institucione dhe persona të tjerë juridikë për realizimin e trajnimeve të kuadrit edukativo-arsimor dhe udhëheqës;
- e përcjell realizimin e shërbimeve të institucioneve të akredituara, institucioneve dhe personave të tjerë juridikë, sa i përket kualitetit dhe kryerjes së shërbimeve sipas afateve të përcaktuara;
- grumbullon informata nga kuadri edukativo-arsimor dhe udhëheqës lidhur me programet e trajnimit;
- siguron kualitet përmes evaluacionit të programeve për trajnimin e kuadrove në institucionet edukative arsimore në bashkëpunim me Inspektoratin shtetëror të arsimit;

dhe

- jep informata për shqyrtimet e konstatuara nga zhvillimi profesional i kuadrit edukativo-arsimor dhe udhëheqës të shkollave dhe institucioneve të tjera.

Neni 9

Në realizimin e kompetencave nga neni 6 pika 4 e këtij ligji, Byroja i kryen punët si vijon:

- kryen studime dhe hulumtime zhvillimore dhe aksionare lidhur me zhvillimin dhe përparimin e punës edukative arsimore;
- organizon diskutime profesionale dhe shkencore për hulumtimin e problemeve dhe temave aktuale në arsim të ne dhe në vendet e tjera;
- përgatit plane afatgjate për hulumtime themelore në bashkëpunim me institucionet e arsimit sipëror në Republikën e Maqedonisë dhe institucionet ndërkombëtare;
- përpilon plane vjetore për hulumtime zhvillimore;
- përpilon strategji për zhvillimin e arsimit dhe edukimit;
- nxit paraqitjen e propozimeve për hulumtime në arsim, nga institucionet e arsimit sipëror dhe institucionet shkencore dhe shkollat;
- e organizon dhe koordinon punën e ekipeve profesionale që punojnë në hulumtimet zhvillimore;
- shpall konkurs publik për sigurimin shërbimeve lidhur me hulumtimet themelore në arsim.
- e përcjell realizimin e hulumtimeve dhe i informon shkollat dhe institucionet e tjera;
- në bashkëpunim me institucionet e arsimit sipëror dhe institucionet shkencore, kryen evaluacionin e relevancës së hulumtimeve në arsim; dhe
- e nxit zbatimin e rezultateve nga hulumtimet në sferën e arsimit.

Neni 10

Në realizimin e kompetencave nga neni 6 pika 5 e këtij ligji, Byroja i kryen punët si vijon:

- i jep ndihmë këshillëdhënëse profesionale shkollës për ndryshimet konceptuale dhe sistemore në sistemin edukativo-arsimor;
- jep këshilla profesionale për vetevaluacionin e shkollës dhe përpilimin planeve zhvillimore;
- i koordinon aktivitetet bashkë me ekipin udhëheqës të shkollës, për përpilimin dhe zbatimin e planeve aksionare për masat që duhet të ndërmerren pas evaluacionit integral të kryer;
- propozon standarde për sistemin mentor të kuadrit edukativo-arsimor;
- u ofron ndihmë të rregullt profesionale shkollave për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve shkollore në pajtim me planet zhvillimore;
- kryen punën e rregullt këshillëdhënëse profesionale për arsimtarët dhe edukatorët lidhur me mësimin e lëndëve të përgjithshme arsimore dhe sferave mësimore, si dhe për përcjelljen, kontrollin dhe notimin e nxënësve;
- u jep ndihmë profesionale shkollave me nxënësit me prirje dhe të talentuar dhe propozon masa për përkrahjen e tyre;
- u jep orientime shkollave për shfrytëzimin e resurseve profesionale në nivel shtetëror dhe ndërkombëtar;
- kryen punën instruktive të mentorit dhe ofron ndihmë intervenuese për kuadrin edukativo-arsimor;
- zhvillon program për përmirësimin e kualitetit të mësimin në shkollë, në bazë të raportit

nga evoluimi integral i realizuar, nga ana e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit dhe

- përgatit propozim-masa për përmirësimin e kualitetit të mësimit dhe vlerësimin e mësimdhënësve.

- nxit dhe organizon aktivitete për këmbimin e diturive dhe përvojës profesionale ndërmjet shkollave;

- bashkëpunon me organet e komunës dhe të Qytetit të Shkupit për nevojat e tyre gjatë propozimit të planprogrameve mësimore; dhe

- bashkëpunon me shkollat, me organet e komunave dhe të Qytetit të Shkupit për përmirësimin e kualitetit të mësimit.

Neni 10-a

Në kryerjen e kompetencave nga neni 6 pika 6 të këtij ligji Byroja i kryen punët si vijojnë:

- kryen shqyrtim të drejtpërdrejtë në mënyrën e planifikimeve të njësive mësimore nga aspekti i qëllimeve, përmbajtjeve, aktiviteteve të planifikuara, metodave dhe teknikave për realizim,

- kryen shqyrtim të drejtpërdrejtë të realizimit të njësive mësimore nga aspekti i qëllimeve dhe përmbajtjeve të ligjëratave, zbatimit të inovacioneve, metodave dhe teknikave mësimore dhe shfrytëzimit të mjeteve ndihmëse mësimore dhe mënyrës së sigurimit të mjedisit stimulues,

- kryen shqyrtim të drejtpërdrejtë të mënyrës së planifikimit të vlerësimit nga ana e mësimdhënësve dhe kontrollin e vlerësimit të realizuar dhe

- kryen shqyrtim të drejtpërdrejtë të rekomandimeve të dhëna nga vizitat e realizimit të njësive mësimore nga ana e bashkëpunëtorëve profesionale.

Për shqyrtimin e realizuar profesional përgatitet raport i cili përmban konstatim nga shqyrtim i kryer i drejtpërdrejtë për punët nga paragrafi 1 i këtij neni, respektivisht konstatim për punën e bashkëpunëtorëve profesionale nga paragrafi 1 alineja 4 të këtij neni.

Raporti nga shqyrtimi profesional bashkëngjitet me dosjen profesionale të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë dhe merret parasysh gjatë vlerësimit të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë në evoluimin integral të realizuar nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit.

Byroja miraton plan vjetor për zbatimin e shqyrtimit profesional.

Mënyrën e zbatimit të metodave dhe teknikave gjatë realizimit të shqyrtimit profesional, i përcakton drejtori i Byrosë

Neni 11

Në realizimin e kompetencave nga neni 6 pika 7 e këtij ligji, Byroja i kryen punët si vijon:

- organizon seminare profesionale, këshillime e ngjashëm, në tema që kanë të bëjnë me standardet arsimore të arritjeve të nxënësve;

- bashkëpunon me ekipe profesionale për përcaktimin e standardeve arsimore për arritjet e nxënësve;

- përgatit standarde arsimore për arritjet e nxënësve për lëndët mësimore dhe sferat e arsimit dhe edukimit;

- u jep ndihmë profesionale shkollave për zbatimin e standardeve arsimore për notimin e arritjeve të nxënësve;
- zhvillon mënyra dhe procedura moderne didaktike për përcjelljen, kontrollin dhe notimin e arritjeve të nxënësve;
- kryen vlerësime të jashtëzakonshme të jashtme të arritjeve të nxënësve;
- organizon trajnimin e arsimtarëve për mënyrat dhe teknikat e përcjelljes, kontrollit dhe notimit të nxënësve;
- kryen hulumtime për notimin e nxënësve në arsim.

Neni 12

- Në realizimin e kompetencave nga neni 6 pika 8 e këtij ligji, Byroja i kryen punët si vijon:
- përgatit koncept për librat mësimorë për arsimin e mesëm dhe fillor dhe metodologjinë për vlerësimin e dorëshkrimeve dhe kualitetit të librave mësimorë;
 - propozon programin për botimin e librave mësimorë për arsimin dhe edukimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;
 - propozon programe për botimin e librave mësimorë për programin mësimor eksperimental;
 - në mënyrë permanente e përcjell kualitetin e librave mësimorë, revistave për fëmijë dhe literaturës plotësuese nga sfera e edukimit dhe arsimit dhe
 - jep ndihmë profesionale për literaturën profesionale, revista dhe publikime që kontribuojnë për zhvillimin e edukimit dhe arsimit.

Neni 13

- Në realizimin e kompetencave nga neni 6 pika 9 e këtij ligji, Byroja i kryen punët si vijon:
- botimin e plan-programeve mësimore për arsimin parashkollor, fillor, të mesëm, arsimin e specializuar, arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe për arsimin fillor të të rriturve dhe shpalljen e tyre në faqen zyrtare të Internetit të ministrisë;
 - botimin e doracakëve dhe literaturës tjetër ndihmëse për edukatorët, arsimtarët dhe bashkëpunëtorët profesionalë dhe shpalljen e tyre në faqen zyrtare të Internetit të ministrisë;
 - propozimin e formularëve për evidencën pedagogjike dhe dokumentacionin;
 - botimin e dokumentacionit pedagogjik dhe evidencës për arsimin fillor, si dhe të librit kryesor dhe ditarit të paraleles për arsim të mesëm;
 - i realizon furnizimet publike për shtypjen e dokumentacionit pedagogjik dhe evidencës nga alineja 4 e këtij neni dhe të njëjtat i dorëzon falas në shkolla;
 - e përcjell realizimin e shërbimeve të ofertuesve të zgjedhur të shërbimeve, sa i përket kualitetit dhe kryerjes së shërbimeve sipas afateve të përcaktuara;
 - botimin e revistës për çështje teorike e praktike në sferën e arsimit dhe edukimit;
 - botimin e materialit promovues për aktualitetet në edukim dhe arsim dhe shpalljen e tyre në faqen zyrtare të Internetit të Ministrisë;
 - botimin e katalogut të programeve të akredituara për trajnimin e kuadrove edukative arsimore dhe shpalljen e tij në faqen zyrtare të Internetit të ministrisë;
 - botimin e katalogjeve të diturive dhe shpalljen e tyre në faqen zyrtare të Internetit të ministrisë.

Neni 14

Në realizimin e kompetencave nga neni 6 pika 12 e këtij ligji, Byroja i kryen punët si vijon:

- vendosjen e sistemit informativ dhe të bazës së të dhënave për arsimin parashkollor, fillor, të mesëm, arsimin e specializuar, arsimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe arsimin e rriturve;
- grumbullimin, rregullimin dhe përpunimin e informatave dhe të dhënave nga sfera e arsimit parashkollor, fillor, të mesëm, edukimit të specializuar, arsimit të nxënësve me nevoja të posaçme arsimore dhe arsimit të rriturve;
- grumbullimin, rregullimin dhe ruajtjen e dokumentacionit pedagogjik me rëndësi për arsimin në Republikën e Maqedonisë (planet mësimore, programet, librat mësimorë, monografite, etj.); dhe
- furnizimin me literaturë profesionale dhe revista nga vendi dhe jashtë për nevojat e veta.

FSHEHTËSIA E MATERIALEVE TË PROVIMIT

Neni 14-a

Punonjësit në Byro dhe bashkëpunëtorët e jashtëm që bashkëpunojnë me Qendrën Shtetërore të Provimeve, në përgatitjen e testeve për kontroll ekstern të arritjeve të nxënësve, janë të obliguar që të nënshkruajnë deklaratë se do të udhëhiqen sipas procedurave për fshehtësinë e përgatitjes, shpërndarjes dhe ruajtjes së materialit për kontroll ekstern të arritjeve të nxënësve.

Procedurat për fshehtësinë e përgatitjes, botimit, shpërndarjes, ruajtjes dhe vlerësimit të materialit të provimeve, i përgatit Qendra Shtetërore e Provimeve, ndërsa i përcakton ministri.

III. ORGANIZIMI I BYROSË

Neni 15

Pozicionimi organizativ i Byrosë rregullohet me aktin e organizimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Emri i vendeve të punës, detyrat dhe fushëveprimi i punës dhe numri i kryerësve në Byro, rregullohen me aktin për sistematizimin e vendeve të punës.

Neni 16

Për kryerjen e punëve nga kompetenca e Byrosë jashtë selisë, e veçanërisht për kryerjen e punës profesionale këshillëdhënëse dhe instruktive të mentorit të kuadrit edukativo-arsimor dhe udhëheqës nga neni 10 i këtij ligji, krijohen forma organizative që përcaktohen me aktin e organizimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Neni 17

Punët nga neni 6 të këtij ligji nga kompetenca e Byrosë i kryejnë nëpunësit shtetërorë, të cilët përveç kushteve të përgjithshme për punësim, të përcaktuara me ligj, i plotësojnë edhe kushtet e veçanta si vijojnë:

- kanë së paku përvojë pesëvjeçare në punën edukative arsimore;
- kanë të botuara punime profesionale, përkatësisht shkencore që janë me rëndësi për përparimin e edukimit dhe arsimin;
- kryejnë hulumtime dhe zotërojnë me metodologjinë e punës shkencore hulumtuese, në sferën e edukimit dhe arsimin;
- kanë marrë pjesë në tubime shkencore profesionale për arsim, me punimet e veta; dhe
- shërbehen me një gjuhë të huaj.

Neni 18

Për kryerjen e punëve nga kompetenca e vet, Byroja drejtpërdrejt bashkëpunon me Inspektoratin shtetëror të arsimit, institucione të arsimit sipëror dhe shkencore, organet e komunës, përkatësisht të Qytetit të Shkupit, shkollat, institucionet ndërkombëtare të arsimit si dhe me institucione të tjera dhe shoqata.

Byroja bashkëpunon me Inspektoratin shtetëror të arsimit për promovimin e kualitetit të arsimit, veçanërisht për sferat si vijon: organizimin dhe realizimin e mësimin, kushtet dhe kulturën e institucioneve edukative arsimore, menaxhimin, zhvillimin profesional të kuadrove edukative arsimore dhe udhëheqëse, komunikimeve dhe marrëdhënieve me opinionin, bashkëpunimin me prindërit dhe mjedisin.

Për çështjet e përsosjes profesionale të nëpunësve shtetërorë, Byroja veçanërisht bashkëpunon me institucionet e arsimit të lartë dhe shkencore.

IV. FINANCIMI I VEPRIMTARISË SË BYROSË

Neni 19

Mjetet për financimin e Byrosë sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Byroja mund të realizojë hyrje të veta, hyrje nga donacionet dhe nga burime të tjera të përcaktuara me këtë ligj.

Byroja mund të marrë pjesë në financimin e hulumtimeve nga sfera e arsimit që i realizojnë institucionet e tjera.

V. UDHËHEQJA DHE ORGANET PROFESIONALE TË BYROSË

Neni 20

Me Byronë udhëheq drejtori.

Drejtori mund të ketë zëvendës.

Drejtorin dhe zëvendësdrejtorin e Byrosë me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, i emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë me mandat prej katër vjetësh.

Për emërimin e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të Byrosë publikohet shpallje publike në së paku tre gazeta ditore të cilat botohen në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, nga të cilat një nga gazetatat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% nga qytetarët që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase. **3**

Neni 21

4

Për drejtor dhe zëvendësdrejtor të Byrosë mund të emërohet personi që i plotëson këto kushte:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- 3) ka marrë së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të kryer VII/1 të arsimit;
- 4) ka minimum pesë vjet përvojë pune në punën edukativo-arsimore dhe i plotëson kushtet nga neni 17 alinetë 2, 3 dhe 4 të këtij ligji;
- 5) posedon një nga certifikatat ose dëshmitë e pranuar ndërkombëtare vijuese për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet: **5**
 - TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
 - IELTS (IELTS) - së paku 6 pikë,
 - ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2 (B2),
 - FCE (FCE) (Cambridge English: First) - i dhënë,
 - BULATS (BULATS) - së paku 60 pikë ose
 - APTIS (APTIS) - së paku niveli B2 (B2) dhe
- 6) ka të dhënë test psikologjik dhe test për integritet.

Zëvendësi e zëvendëson drejtorin në rast të mungesës ose pengesës, me të gjitha autorizimet dhe përgjegjësitë e tij në udhëheqje.

Neni 22

Drejtori i Byrosë mban përgjegjësi për punën e tij dhe për punën e Byrosë, para Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

Drejtori i Byrosë miraton programin vjetor për punën e Byrosë dhe e organizon realizimin e tij.

Drejtori për punën e tij dhe për punën e Byrosë paraqet raportin vjetor te ministri i Arsimit dhe Shkencës e sipas nevojës edhe në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë.

Neni 23

Për kryerjen e punëve profesionale nga kompetenca e Byrosë, drejtori mund të formojë ekipe profesionale me pjesëmarrjen e ekspertëve të jashtëm profesionalë dhe shkencorë apo personave juridikë.

Përbërjen dhe numrin e anëtarëve të ekipeve profesionale, i përcakton me aktvendim drejtori i Byrosë.

VI. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 24

Nëpunësit ekzistues profesionalë shtetërorë të Byrosë që nuk i plotësojnë kushtet e veçanta nga neni 17 i këtij ligji, obligohen që në afat prej dy vjetësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, t'i plotësojnë kushtet e veçanta, në të kundërtën u pushon marrëdhënia e punës.

Dispozitat nga paragrafi 1 i këtij neni nuk kanë të bëjnë me nëpunësit profesionalë shtetërorë, nëse në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë edhe pesë vjet deri në realizimin e së drejtës për pension sipas pleqërisë.

Neni 25

Nëpunësit ekzistues shtetërorë të Byrosë që nuk i kryejnë punët nga neni 6 i këtij ligji, vazhdojnë t'i kryejnë punët në vendet e punës në të cilat kanë qenë deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas Ligjit për nëpunësit shtetërorë.

Neni 26

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të zbatohet nga 1 janari 2007.